



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2022:167641

Datë: 08.04.2024

Numri i dokumentit: 05558883

P.nr.650/2022

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Xhemajl JUSUFI, me praktikanten e rregullt të kësaj gjykate Leonita Sadiku, në lëndën penale ndaj të pandehurit K.M. për shkak të veprës penale Vjedhje e rëndë nga neni 315 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Kodit Nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës (tutje si: KPRK), duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.1172/2021 (2021:0044389) të datës 24.10.2022, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 28.03.2024 në prezencën e Prokurorit të Shtetit Ajtene Zoni, i pandehuri K.M., mbrojtësja sipas detyrës zyrtare e të pandehurit, avokate Nadire Koshi, me datë 02.04.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 08.04.2024 e përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

K.M., me nofkën K. nga i ati L., e ëma G., e vajzërisë K., i lindur me datë në Mitrovicë, me adresë të vendbanimit në Lagjen e Boshnjakëve Rr. "...", me numër personal, ka të kryer shkollën fillore, i pamartuar, i papunë, i gjendjes së dobët ekonomike shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Me datë 30.06.2021, në orët e hershme të mëngjesit (rreth orës 03:50), në Mitrovicë, në lagjen Mahalla e Boshnjakëve, me qëllim që vetit të i sjellë dobi të kundërligjshme pasurore, ka marrë mjetin e huaj të luajtshëm, ashtu që ka kapërcyer murin e oborrit të shtëpisë të dëmtuarës H.K., e cila gjendet në Rr. "Oslobodenja" e pastaj prej automjetit motorik të udhëtarëve të markës "Polo", pronë e të dëmtuarës, i cili ka qenë i parkuar në oborrin e shtëpisë, ka hapur derën e automjetit të cekur e cila nuk ishte e mbyllur me çelës, dhe prej të njëjtit ka marrë llap-topin zyrtarë të markës "...", ne vlerë prej 300 euro, ku pas kësaj të njëjtin ia ka shitur personit të tretë.

Me këtë ka kryer veprën penale: Vjedhje e rëndë nga neni 315 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata, në bazë të nenit 1, 4, 7, 17, 21, 31, 38, 39, 42, 46, 47, 48, 49, 69, 70, 315 të KPRK-së dhe nenit 242, 364, 449, 450, 452 dhe 462 të KPP-së e:

G J Y K O N

- I. DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej tri (3) vite e gjashtë (6) muaj, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.
- II. DËNIM ME GJOBË në shumë prej 200.00 (*me fjalë: dyqind*) euro, të cilin dënim i akuzuari obligohet ta paguaj në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi. Në rast se i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë në afatin e caktuar, Gjkata do të veprojë në bazë të nenit 43 paragrafi 3 të KPRK-së, ashtu që të akuzuarit, dënimin me gjobë do t'ia zëvendësoj në dënim me burgim duke llogaritur për çdo 20 (njëzetë) euro gjobë të papaguar, me një (1) ditë burgim.
- III. Obligohet i pandehuri t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej njëzetë (20) euro, ndërsa në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej nga 20 (njëzetë) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.
- IV. Pala e dëmtuar H.K., për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest të rregullt juridiko – civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore ne Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr 1172/2021 të datës 24.10.2022, kundër të pandehurit K.M. për shkak të veprës penale Vjedhje e rëndë nga neni 315 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Gjkata për këtë çështje penale ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datën 28.03.2024, në të cilën kanë qenë të pranishëm prokurori i shtetit Ajtene Zoni, i pandehuri K.M. si dhe mbrojtësja e të pandehurit, avokate Nadire Koshi, ndërsa ka munguar e dëmtuara H.K..

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të Shtetit, i pandehuri ka deklaruar se e ndjejnë veten fajtor për veprën penale, se e kupton natyrën dhe pasojat juridike të pranimit të fajësisë, pranimin e fajësisë e bëjnë në mënyrë vullnetare, pa presion dhe pas sqarimeve të mjaftuara nga ana e gjykatës për pasojat dhe benefitet e pranimit të fajësisë.

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve ka deklaruar se: konsideroj se janë përmbushur kushtet ligjore për pranimin e fajësisë, pranimi është bërë në

mënyrë vullnetare, pa presion dhe pranimi mbështetet në provat materiale që gjenden në shkresat lëndës, ndërsa lidhur me sanksionin penal, gjykatës i ka propozuar të njëjtin ta shpallë fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit duke i marrë parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese.

Mbrojtësja e të pandehurit, av Nadire Koshi, lidhur me pranimin e fajësisë, i ka propozuar gjykatës që të aprovoj pranimin e fajësisë ndërsa lidhur me sanksionin penal, i ka propozuar gjykatës që gjatë marrjes së vendimit të këtë parasysh si rrethanë lehtësuese pranimin e fajit, keqardhjen e shfaqur nga personi i dënuar, moshën e personit të dënuar, sjelljen e tij, dhe i ka propozuar gjykatës që me rastin e dënimit të jep një dënim sa më të butë.

Gjykata ka shqyrtuar pranimin e fajësisë të cilën e ka deklaruar të pandehurit, e në mbështetje të nenit 242 të KPP-së, në këtë drejtim vlerëson se janë përmbushur kushtet ligjore për pranimin e fajësisë për të pandehurit. Gjykata ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit mbështetet në provat me të cilat disponon kjo gjykatë si: Raporti fillestar të incidentit me numër të rastit 2021-SA-123 i datës 30.06.2021, Procesverbali i marrjes në pyetje për të dëmtuarën H.K. me numër të rastit 2021-BC-123 i datës 30.06.2021, Procesverbali i marrjes në pyetje për të dyshuarin K.M. i datës 08.07.2021, Raporti i oficerit i datës 30.06.2021, Fotoalbumi nga Njësia e Forenzikës si dhe shkresat tjera në lëndë.

Të gjitha këto prova janë bindëse për gjykatën dhe formojnë elementin inkriminues e që në bazë e tij dhe pranimin të fajësisë, vërtetohet për tej çdo dyshimi se i akuzuari ka kryer veprën penale që i vihet në barrë.

Gjykata ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë në mënyrë vullnetare dhe se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, duke i ‘u tërhequr vërejtja të pandehurit se pas pranimin të fajësisë, nuk mund të bëjnë ankesë për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, por vetëm sa i përket llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata ka vërtetuar se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabim faktik, nga këto arsye gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë të bërë nga të pandehurit.

Gjykata, nga pranimi i fajësisë së të pandehurve dhe nga provat e cekura si më lart, ka vërtetuar përtej dyshimit të bazuar se i pandehuri K.M. ka kryer veprën penale: Vjedhje e rëndë nga neni 315 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 të KPRK-së, për të cilën vepër penale parashihet dënimi me gjobë dhe me burgim prej tre (3) deri në shtatë (7) vjet.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata ka pasur parasysh vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së.

Si rrethanë lehtësuese për të pandehurin K.M., gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë në tërësi për veprën penale, sjellja korrekte e të pandehurin në gjykatë, keqardhjen dhe kërkim faljen e shprehur nga i pandehuri në seancë gjyqësore për rastin që ka ndodhur dhe premtimin bërë para gjykatës se nuk do të përsërisë veprime të tilla.

Si rrethana rënduese për të pandehurin K.M., gjykata vlerëson dashjen e lartë të të pandehurit në kryerjen e kësaj veprë penale, rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale, ndërsa si rrethanë posaçërisht rënduese për të pandehurin, gjykata ka gjetur faktin se i njëjti ishte edhe më parë i dënuar me vendim të plotfuqishëm të gjykatës, në dymbëdhjetë raste dhe atë: me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore Mitrovicë në lëndën penale PM.28/2018, i plotfuqishëm nga data 14.08.2020; me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë në lëndën penale P.nr.133/2021, i plotfuqishëm me datën 13.07.2021; me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë në lëndën penale P.nr.359/2021 i plotfuqishëm me datë 28.10.2021; me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë, në lëndën penale P.nr.556/2021 e plotfuqishëm me datë 14.03.2022; me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë, në lëndën penale P.nr.713/2021 i plotfuqishëm me datë 10.03.2022; me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë në lëndën penale P.nr.146/2021 i plotfuqishëm me datë 26.04.2022; me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë, në lëndën penale P.nr.223/2021 i plotfuqishëm me datë 01.04.2022; me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë, në lëndën penale P.nr.108/2021 i plotfuqishëm me datë 11.03.2022, me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë në lëndën penale P.nr.134/2021 i plotfuqishëm me datë 14.10.2021, në lëndën penale P.nr.259/2021 i plotfuqishëm me datë 31.05.2022 me Aktgjykim në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, në lëndën penale P.nr.237/2022 e plotfuqishëm me datë 29.07.2022 si dhe me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë në lëndën penale P.nr.405/2022 i plotfuqishëm me datë 04.12.2023.

Nga këto raste, i pandehuri K.M., në njëmbëdhjetë raste është dënuar për veprën penale vjedhje e rëndë, çka për këtë gjykatë, ky fakt tregon mjaftueshëm se i pandehuri është përsëritës i veprave penale dhe edhe përkundër faktit se më parë ishte i dënuar, i njëjti ka vazhduar me veprimet e tij të kundërligjshme.

Duke marrë parasysh të gjitha këto rrethana si dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, gjykata vlerëson se shqiptimi i dënimit me burg efektiv dhe dënim me gjobë për të pandehurin, janë dënime të drejta, në harmoni me peshën e veprave penale respektive dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit. Po ashtu, Gjykata vlerëson se edhe me këtë dënim, do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 të KPRK-së, që t'i parandaloj kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, si dhe të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale si dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit. Po ashtu, ky dënim do të shërbejë si masë preventive që në të ardhmen të pandehurit të përmbahen nga çfarëdo veprimi që është i dëmshëm për shoqërinë në përgjithësi.

Vendimin për shpenzimet e procedurës gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449, 450 dhe 452 të KPP-së, që kanë të bëjnë me shpenzimet e paushallit Gjyqësor, ndërsa taksa për kompensimin viktimave të krimit, në kuptim të nenit 36 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të Ligjit nr.08\L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarit për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontestin civil është marrë në kuptim të nenit 462 par. 1 dhe 2 të KPP-së.

Andaj gjykata duke u bazuar me neni 242, 364, 449, 450, 452 dhe 462 të KPP-së, nga arsyet e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.650/2022, datë 05.04.2024

Zyrtarja ligjore
Doruntina BEKA

Gjyqtari
Xhemajl JUSUFI

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimi të Aktgjykimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe palët kundërshtare.